



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria-Vlada-Government

Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë
Ministarstvo Industrije, Preduzetništva i Trgovine - Ministry of Industry,
Entrepreneurship and Trade

Agjencia për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë
Kosovo Investment and Enterprise Support Agency
Agencija za Investicije i Podršku Preduzeća na Kosovu

Thirrje e rishpallur publike për aplikim për pjesëmarrje në shtandin shtetëror të Kosovës në panairin “ENOEXPO” në Krakow, Poloni, me 08-10 nëntor 2023

Me qëllim të promovimit të kompanive prodhuese kosovare në gjetjen e tregjeve të huaja për eksport të produkteve dhe shërbimeve, Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë (MINT) përmes Agjencisë për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë (KIESA) shpallë:

Paraqitja shtetërore organizohet nga MINT përkatësisht KIESA, e cila mbulon shpenzimet e hapësirës ekspozuese, ndërtimin e shtandit, regjistrimin e dhjetë (10) subjekteve pjesëmarrëse [tri (3) prej tyre startup (e themeluar 1-6 vjetet e fundit)], shpenzimet e energjisë elektrike, pastrimin ditor, etj., ndërsa shpenzimet e udhëtimit, akomodimit, ushqimit, dërgimin e materialeve promovuese, etj. të subjekteve pjesëmarrëse do të merren përsipër nga vet subjektet pjesëmarrëse.

Shprehjet e interesimit të dërguara deri me datë 03.10.2023 dhe aplikacionet e plotësuara tërësisht do të konsiderohen për vlerësim.

Për të aplikuar duhet dorëzuar:

1. Aplikacionin e plotësuar më të dhënat bazike të subjektit aplikues;
2. Dëshminë që subjekti aplikues është i regjistruar në Republikën e Kosovës;
3. Dëshminë e xhirollogarisë aktive në njërin prej bankave të licencuara nga Banka Qendrore e Kosovës;
4. Kopjen e letërnjoftimit të personit të autorizuar të subjektit aplikues;
5. Vërtetimin nga gjykata që dëshmon që personi i autorizuar i subjektit nuk është nën hetime (kërkohet origjinali, jo me i vjetër se 30 ditë);
6. Deklaratën nën betim;

7. Vërtetimin e qarkullimit vjetor të subjektit aplikues për vitin fiskal 2022 nga Administrata Tatimore e Kosovës; dhe
8. Vërtetimin tatimor të subjektit aplikues për obligimet e kryera ndaj Administratës Tatimore të Kosovës, jo më e vjetër se gjashtë (6) muaj.

Në mungesë të cilit do dokument të kërkuar në listën e mësipërme aplikacioni i subjektit aplikues do të diskualifikohet dhe nuk do të shqyrtohet tutje për kriteret e veçanta të listuara më poshtë.

Dhjetë (10) subjekteve pjesëmarrëse [tri (3) prej tyre startup) do të përzgjidhen sipas kriterëve të veçanta në vijim dhe rangimit të pikëve:

- Produktet që subjekti aplikues do të ju ofrojë blerësve potencial në panair, maksimum pesëmbëdhjetë (15) pikë: tri (3) pikë për një (1) produkt, gjashtë (6) pikë për dy produkte, nëntë (9) pikë për tri (3) produkte, dymbëdhjetë (12) pikë për katër (4) produkte dhe pesëmbëdhjetë (15) pikë për pesë (5) e më shumë produkte;
- Njohuria e gjuhëve të huaja dhe aftësi prezantuese të përfaqësuesve të subjektit aplikues, maksimum pesëmbëdhjetë (15) pikë kumulative: gjuha Angleze gjashtë (6) pikë, gjuha Gjermane gjashtë (6) pikë dhe gjuhët tjera tri (3) pikë;
- Materiale promovuese të subjektit aplikues në gjuhët e huaja, maksimum pesëmbëdhjetë (15) pikë kumulative: në gjuhën Angleze gjashtë (6) pikë, në gjuhën Gjermane gjashtë (6) pikë dhe tre (3) pikë në gjuhë tjera evropiane;
- Shtetet ku janë eksportuar produktet e subjektit aplikues gjatë vitit 2022, maksimum pesëmbëdhjetë (15) pikë kumulative: shtetet anëtare të BE-së gjashtë (6) pikë, shtetet e Ballkanit Perëndimor që nuk janë anëtare të BE-së (Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Serbia, Mali i Zi dhe Maqedonia) gjashtë (6) pikë dhe tregjet e tjera tre (3) pikë;
- Certifikimi ndërkombëtar i subjektit aplikues, maksimum pesëmbëdhjetë (15) pikë kumulative: HACCP gjashtë (6) pikë, ISO 22000 gjashtë (6) pikë dhe certifikim tjetër relevant tre (3) pikë;
- Paraqitja e subjektit aplikues në panair tri (3) vitet e fundit, maksimum pesëmbëdhjetë (15) pikë: një (1) panair tri (3) pikë, dy (2) panair gjashtë (6) pikë, tri (3) panair nëntë (9) pikë, katër (4) panair dymbëdhjetë (12) pikë dhe pesë (5) e më shumë panair pesëmbëdhjetë (15) pikë; dhe
- Qarkullimi vjetor i subjektit aplikues gjatë vitit fiskal 2022, maksimumi dhjetë (10) pikë: nga zero deri në 500.000 euro katër (4) pikë; nga 500.001 deri në 1.000.000 euro tetë (8) pikë dhe mbi 1.000.000 euro dhjetë (10) pikë;

Më 29.09.2023, në ora 13:00, në sallën e takimeve të KIESA-s, organizohet sesioni informues ku zyrtarët e KIESA-s do të përgjigjen pyetjeve lidhur me organizimin e

panairit dhe mbështetjen e kompanive për pjesëmarrje në këtë panair. Subjektet që kanë nevojë për asistencë për plotësimin e këtij formulari, këshillohen gjithashtu të marrin pjesë në këtë takim.

Të drejtën e aplikimit e kanë të gjitha kompanitë vendore të cilat konsiderohen se kanë potencial për eksport të produkteve duke pasur parasysh sektorët specifik të panairit dhe llojit të produkteve që ekspozohen në stendën e përbashkët shtetërore në këtë panair.

Përparësi në përzgjedhje do të kenë subjektet të cilat nuk kanë marr pjesë në panaire ndërkombëtare në dy vitet e fundit të organizuara nga MINT/KIESA. Në rastet kur nuk plotësohet numri maksimal i subjekteve të kërkuara sipas kriterëve për pjesëmarrje, atëherë do të merren parasysh aplikuesit tjerë të radhës.

Subjektet që dëshirojnë të aplikojnë për të marrë pjesë në panair duhet të shprehin interesimin e tyre duke plotësuar aplikacionin dhe ta dërgojnë në mënyrë elektronike më së largu deri më 03.10.2023 në e-mail adresën: Export.Kiesa@rks-gov.net

Në momentin e aplikimit subjekti pranon të gjitha përgjegjësitë, obligimet, kriteret dhe detyrat e parapara me legjislacionin në fuqi dhe kriteret e veçanta të parapara në këtë thirrje publike.

Informimi dhe pyetësori për shprehje të interesit mund të merren në KIESA-MINT apo të shkarkohen nga faqet e internetit:

mint.rks-gov.net dhe kiesa.rks-gov.net apo në e-mail adresën:
Export.Kiesa@rks-gov.net